



Instituti i Kërkimeve Urbane

FLETË INFORMUESE MBI PROJEKTET

Instituti i Kërkimeve Urbane

Hartimi i një skeme PPP për menaxhimin e mbetjeve të riciklueshme në bashkinë e Beratit

Konteksti i projektit

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit në Berat vazhdojnë të kenë një zhvillim të pakët. Menaxhimi i mbetjeve i munguar ulë standardin e jetesës si dhe pengon zhvillimin sidomos për zonat me potencial të lartë për turizmin. Burimet natyrore dhe kulturore si lumenjtë, pyjet si dhe vendet arkeologjike janë në veçanti në rrezik, ku cilësia e tyre përkeqësohet si pasojë e grumbullimit të mbetjeve, duke kërcënuar qëndrueshmërinë ekonomike të aktiviteteve të varura nga turizmi.

Qëllimi i projektit

Qëllimi i përgjithshëm i PPP është të strukturoj marrëdhëniet ndërmjet Bashkisë së Beratit dhe sektorit privat në një mënyrë të tillë që aktivitetet dhe risqet që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve, shpërndarja dhe sistemimi i tyre t'u akohet paleve të treta të cilat mund t'i menaxhojnë më mirë ato.

Metodologjia

Gjatë zhvillimit të këtij projekti, IKU ka patur avantazhe nga eksperianca relevante kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nga çdo



dokument tjetër planifikimi që lehtëson konceptimin e një studimi të mundshëm që mund ta bëjë projektin të tregtueshëm dhe me interes për investitorët privat potencial. Zbatimi i projektit do të kërkojë mobilizimin e investimeve kapitale private në mbledhjen, asgjësimin dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme, duke përfshirë një fushatë intensive ndërgjegjësimi dhe edukimi.

Aktivitete e projektit

Nga pikpamja teknike, dhënia e koncesionit, është plotësisht i mundshëm, për shkak të faktit se, në rajonin e Beratit dhe kudo tjetër në vend ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe një industri ricikluese në rritje, të cilat janë të interesuara dhe të afta në ngritjen e një sistemi të mbledhjes së diferencuar të mbetjeve më të paktën dy rryma si dhe ndërtimin dhe operimin e

fasiliteteve respektive për realizimin e riciklimit dhe kompostimit.

FAKTET KRYESORE

DONATORËT:

✓ USAID

KOHËZGJATJA:

Gusht 2013-Korik 2014

PËRFITUESIT:

✓ Rrethi i Beratit

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitet e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.